



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 dhe nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 10.11.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin DPKI-OFUETI-0225, për (ish) zyrtarin z. Fitim Gagica, pasi që i njëjti në kundërshtim me nenin 6 dhe 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në cilësi të asambleistit në Kuvendin Komunal të Komunës së Kamenicës, ka marrë pjesë në votim - vendimmarrje lidhur me propozim - vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2025 - 2033, në të cilin plan është përfshirë kërkesa (individuale) e tij për lejimin e shndërrimit të pronave (parcelave) të tij në tokë ndërtimore dhe aprovimi i saj për shtatë (7) parcela.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon nga Kuvendi Komunal i Komunës së Kamenicës revokimin ose shfuqizimin e Vendimit nr. 01-21270, i datës 06.08.2025 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, si akti i nxjerrë nën rrethana të konfliktit të interesit, ashtu që votimi i këtij plani të (ri)kthehet në Kuvendin Komunal për votim nga një përbërje pa konflikt të interesit, dhe më pas të njoftohet Agjencia për masat e ndërmarra.
- III. Lidhur me konstatimin për shkelje si në pikën I. të dispozitivit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit do të inicoj procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente ndaj (ish) zyrtarit z. Fitim Gagica.
- IV. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Fitim Gagica, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI) dhe Rregulloren nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-OFUETI-0225), me të cilën është parashtruar dyshimi për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionin publik për (ish) zyrtarin z. Fitim Gagica, pasi që siç pretendohet në raportimin e rastit, i njëjti ka marrë pjesë në seancën e Kuvendit Komunal (KK) të Komunës së Kamenicës e mbajtur më datë 31.07.2025, duke bërë kuorumin për vendimmarrje dhe duke votuar për propozim - vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Kamenicës (në vijim: PZHK), ndërkohë që, gjithnjë sipas pretendimit të raportuesit të rastit, në këtë PZHK janë përfshirë me kërkesën e zyrtarit në fjalë disa parcela në pronësi të tij, ashtu që të njëjtat janë shndërruar në toka ndërtimore sipas kërkesës së z. Fitim Gagica.

Tutje raportuesi i rastit, lidhur me shkeljet e dyshuara për konflikt të interesit, i është referuar dispozitës së nenit 38 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale dhe dispozitës së nenit 6 të LPKI-së.

Nga shkresa e raportimit të rastit dhe dokumentacioni i bashkangjitur rezulton se, çështja e PZHK-së është adresuar edhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, përveç dyshimeve për konflikt të interesit edhe lidhur me dyshimet për (kundër)ligjshmërinë dhe (pa)rregullsinë e nxjerrjes miratimit të PZHK-së nga KK i Komunës së Kamenicës.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ në kontekst të dyshimeve për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, duke trajtuar dhe shqyrtuar këtë çështje vetëm sa i përket pretendimit për konflikt të interesit në lidhje me votimin - pjesëmarrjen në vendimmarrje të z. Fitim Gagica, për propozim - vendimin për miratimin PZHK-së, në të cilin plan me kërkesën e tij është përfshirë edhe ndryshimi i destinimit të pronës (parcelave) së tij private në tokë ndërtimore.

Pra, Agjencia nuk ka trajtuar ligjshmërinë e PZHK-së e as rregullsinë e procesit të hartimit dhe miratimit të këtij plani, pasi që çështjet e tilla nuk janë në kompetencë të Agjencisë sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-1874/25, e ka njoftuar z. Fitim Gagica lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjenci, me ç'rast (ish) zyrtari në fjalë është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket këtyre pretendimeve.

Në takimin e mbajtur, z. Fitim Gagica ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij përkitazi me pretendimet e ngritura. Ndër të tjera, në takimin e mbajtur zyrtari në fjalë ka deklaruar se në cilësi të pronarit të pronës së paluajtshme, sikurse edhe qytetarët tjerë ka paraqitur kërkesë që prona (parcelat) e tij të shndërrohet në tokë ndërtimore, si dhe ka pranuar se në cilësi të asambleistit të KK i Komunës së Kamenicës ka marrë pjesë në votimin e PZHK-së. Por i njëjti ka theksuar se nuk ka qenë ne dijeni se kjo situatë mund të ishte konflikt i interesit dhe për këtë nuk e kishte njoftuar apo këshilluar nga askush. Në takimin e mbajtur, z. Fitim Gagica ka dorëzuar tre (3) procesverbale të mbledhjeve të KK i Komunës së Kamenicës lidhur me PZHK-në.

Me qëllim të sqarimit të situatës, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-2068/25, ka kërkuar nga Komuna e Kamenicës informata dhe dokumentacion lidhur me procesin e hartimit dhe miratimit të PZHK-së. Agjencia ka pranuar nga Komuna e Kamenicës përgjigjen me informatat dhe dokumentacionin e kërkuar (DPKI-2095/25).

Kësisoj, Agjencia pasi ka analizuar dhe administruar si prova (ato që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit) informatat e pranuar nga raportuesi i rastit përfshirë dokumentacionin e bashkangjitur, informatat, sqarimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga z. Fitim Gatica në takimin e mbajtur, përgjigjen e Komunës së Kamenicës dhe dokumentacionin e bashkangjitur, si dhe informatat tjera të siguruar sipas detyrës zyrtare, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të LPKI-së, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Referuar deklaramentit - pohimit të palës z. Fitim Gatica, i njëjti ka qenë asambleist i KK të Komunës së Kamenicës që katër (4) vite, përkatësisht nga viti 2021 deri në vitin 2025. Kjo vërtetohet edhe nga informatat publike në uebfaqen e Komunës së Kamenicës.¹

Referuar Raportit të shqyrtimit publik të PZHK-së nr. 02-9895, i datës 28.04.2025, rezulton se z. Fitim Gatica në cilësi të pronarit të pronës së paluajtshme, më datë 06.12.2024, përmes librit të shënimeve, ka parashtruar kërkesë (individuale) për lejimin e shndërrimit të pronave (parcelave) të tij në tokë ndërtimore.

Sipas dokumentit të sipërcituar, nga katërmëdhjetë (14) njësi kadastrale pronë e tij, për të cilat z. Fitim Gatica ka kërkuar ndërrim të destinimit (shndërrim në tokë ndërtimore), për shtatë (7) parcela i është aprovuar kërkesa, ndërsa për shtatë (7) parcela i është refuzuar.

Referuar Procesverbalit nr. 01-22961, nga mbledhja e VII-të e KK të Komunës së Kamenicës e mbajtur më datë 31.07.2025, rezulton se pika katër (4) e rendit të ditës ka qenë propozim - vendimi për miratimin e PZHK-së.

Sipas këtij procesverbali, propozim - vendimi për miratimin e PZHK-së është miratuar, ashtu që në votim kanë marrë pjesë katërmëdhjetë (14) asambleist, ku me katërmëdhjetë (14) vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është miratuar PZHK-ja. Kjo është konstatuar edhe nga përgjigja zyrtare e Komunës së Kamenicës.

Sipas përgjigjes zyrtare të Komunës së Kamenicës, rezulton se sipas legjislacionit në fuqi, numri i asambleistëve në KK të Komunës së Kamenicës në mandatin 2021-2025 është njëzet e shtatë (27), ndërsa kuorumi për vendimmarrje për miratim të PZHK-së është katërmëdhjetë (14) asambleist.

Bazuar në Listën e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në mbledhjen e datës 31.07.2025, të KK të Komunës së Kamenicës, rezulton se z. Fitim Gatica ka marrë pjesë në këtë mbledhje dhe ka votuar për PZHK. Kjo është konfirmuar edhe nga pohimi i vet palës, i cili ka pranuar se ka marrë pjesë në mbledhje dhe votim të PZHK-së.

Rrjedhimisht, pjesëmarrja e z. Fitim Gatica në votimin e PZHK-së, ka qenë përcaktuese për kuorumin e vendimmarrjes së KK-së për miratimin e PZHK-së, duke pasur parasysh se numri

¹ <https://kamenice.rks-gov.net/staff/fitim-gatica/>

asambleistëve që kanë marrë pjesë në votim është katërmëdhjetë (14), aq sa është edhe kurumi për vendimmarrje.

Nga përgjigja zyrtare e Komunës së Kamenicës në pyetjen e Agjencisë së: *"Gjatë procesit të diskutimit dhe aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal, a ka pasur ndonjë kërkesë prej palëve për përjashtim nga procedura e vendimmarrjes së ndonjë anëtarit të Kuvendit Komunal dhe a ka pasur ndonjë deklaram të konfliktit të interesit nga këta anëtarë, në raport me çështjen për të cilën është votuar [...]"*, është theksuar se: *"Duke u bazuar në procesverbalin e kësaj seance, nuk kemi pasur kërkesë për përjashtim nga procedura e vendimmarrjes së ndonjë anëtarit/e të Kuvendit Komunal si dhe nuk ka pasur asnjë deklaram të konfliktit të interesit nga asnjë anëtar/e."*

Më pas, KK i Komunës së Kamenicës ka nxjerrë Vendimin nr. 01-21270, i datës 06.08.2025, për miratimin e PZHK-së.

Bazuar në pikën 2.3 të dispozitivit të vendimit si më lartë, Raporti i shqyrtimit publik të PZHK-së, në të cilin është përfshirë kërkesa (individuale) e parashtruar nga z. Fitim Gagica, për lejin e shndërrimit të pronave (parcelave) të tij në tokë ndërtimore, si dhe aprovimi i kërkesës së tij për shtatë (7) parcela, është pjesë e Vendimit nr. 01-21270, i datës 06.08.2025, për miratimin e PZHK-së.

Rrjedhimisht, z. Fitim Gagica, në cilësi të asambleistit të KK i Komunës së Kamenicës, ka marrë pjesë në vendimmarrje - ka votuar, madje pjesëmarrja dhe vota e tij kanë qenë përcaktuese për kuorum të vendimmarrjes, për miratimin e PZHK-së pjesë e të cilit plan është edhe kërkesa e tij (individuale) dhe aprovimi i saj (për shtatë parcela) për shndërrim të pronës së tij private në tokë ndërtimore.

Në vështrim të pretendimeve të ngritura dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, për arsyet si në vijim:

I. Konstatimi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi se, ekziston konflikti i interesit për (ish) zyrtarin z. Fitim Gagica, pasi që i njëjti në cilësi të asambleistit në KK të Komunës së Kamenicës, ka marrë pjesë në votim - vendimmarrje lidhur me propozim - vendimin për miratimin e PZHK-së, në të cilin plan me kërkesën e tij është përfshirë edhe ndryshimi i destinimit të pronës (parcelave) së tij private në tokë ndërtimore, është bazuar në nenin 6 dhe 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat për vete* apo për personat e afërm me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka **interes privat**, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, **detyrohet** që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së **interesit të tij privat** ose të personave të afërm me të"*

lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konfliktit të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”*. Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definon nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave të sipërcituara të LPKI-së, pjesëmarrja e z. Fitim Gatica në votim për miratimin e PZHK-së, i cili votim ka rezultuar me nxjerrjen e Vendimit nr. 01-21270, i datës 06.08.2025, për miratimin e PZHK-së, është situatë e konfliktit të interesit në vendimmarrje për interes privat.

Kjo për faktin se, siç është konstatuar, z. Fitim Gatica në cilësi të asambleistit të KK i Komunës së Kamenicës, ka qenë pjesë e vendimmarrjes duke votuar për miratimin e PZHK-së (vendimmarrja), pjesë e të cilit vendim është edhe Raporti i shqyrtimit publik të PZHK-së, ku është përfshirë kërkesa (individuale) e parashtruar nga ai, për lejimin e shndërrimit të pronave (parcelave) të tij në tokë ndërtimore, si dhe aprovimi i kërkesës së tij për shtatë (7) parcela (interesi privat).

Pra në këtë rast, janë plotësuar dy kushtet kumulative të ekzistimit të konfliktit të interesit në vendimmarrje, e që janë *“pjesëmarrja në vendimmarrje”* dhe *“ekzistimi i interesit privat”*. Ashtu që, votimi i z. Fitim Gatica për PZHK-në nënkupton pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, ndërsa përfshirja në PZHK e kërkesës së tij individuale dhe e aprovimit të kësaj kërkesë për shndërrimin e shtatë (7) parcelave në tokë ndërtimore, nënkupton interesin e tij privat në çështjen e miratimit të PZHK-së.

Me këtë rast, z. Fitim Gatica nuk ka zbatuar obligimet që dalin nga dispozita e nenit 5 [Parimet e veprimt dhe mosveprimt të zyrtarit], paragrafi 8 i LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje”* dhe nenit 8 [Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit], paragrafi 1 të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private”*. Si dhe nuk ka ndërmarrë masat e përcaktuara me nenin 19 [Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave], paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave: [...] 1.2. merr masa për vetëpërfshirjen ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt [...]”*.

Përveç kësaj, edhe me dispozitën e nenit 38 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale është përcaktuar se: *“Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me*

cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material."

Agjencia ka pasur parasysh deklarimin e z. Fitim Gatica në takimin e mbajtur se *nuk ka qenë ne dijeni se kjo situatë mund të ishte konflikt i interesit dhe për këtë nuk e kishte njoftuar apo këshilluar nga askush*, por kjo rrethanë nuk e përjashton të njëjtin nga obligimi i tij për ta deklaruar konfliktin e interesit dhe për t'u (vet)përjashtuar nga pjesëmarrja në votim – vendimmarrje. Kjo për faktin se, nga sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 8, paragrafi 1 të LPKI-së, detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit (deklarimi dhe vetpërjashtimi), në rend të parë bie mbi vet zyrtarin, në këtë rast z. Fitim Gatica. Ndërkohë që nga shkresat e lëndës dhe nga përgjigja zyrtare e Komunës së Kamenicës, rezulton se i njëjti nuk ka deklaruar konflikt të interesit e rrjedhimisht as nuk është (vet)përjashtuar nga pjesëmarrja në votimin e PZHK-së.

Gjithashtu, Agjencia ka pasur parasysh edhe sqarimin e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Kamenicës se, citojmë fragmentin nga përgjigja: *"Dokumentet strategjike siç është Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), trajtojnë tërësinë territoriale brenda kufijve kadastral komunal. Përderisa asambleja komunale përbëhet detyrimisht nga asambleist që duhet të jenë qytetar të kësaj komune, prandaj të gjithë asambleistët, ose janë pronarë të drejtpërdrejtë të ndonjë parcele brenda territorit kadastral të komunës, ose janë trashëgimtarë të pronareve të ndonjë parcele brenda territorit kadastral të komunës. Prandaj nëse votimi i asambleistëve për PZHK-në do të konsiderohej i jashtëligjshëm me arsyetimin se PZHK ka trajtuar parcelat e ndonjë asambleisti, i bie që çdo asambleist që ka votuar, ka shkaktuar konflikt interesi. Nëse kjo do të konsiderohej konflikt interesi, atëherë lind pyetja, se në cilën asamble komunale do të duhej të miratohej PZHK-ja, siç e kërkon ligji i Planifikimit Hapësinor."* Por "interpretimi" i tillë në rastin konkret të vendimmarrjes së z. Fitim Gatica, në kuptim të dispozitave të LPKI-së, është i paqëndrueshëm.

Kjo për faktin se, konstatimi i konfliktit të interesit në rastin e z. Fitim Gatica, nuk ka të bëjë me faktin se i njëjti është pronar i pronës së paluajtshme e cila gjindet në Komunën e Kamenicës dhe që ajo pronë ka qenë pjesë e PZHK-së, sepse Agjencia ka parasysh se PZHK-ja është një dokument (akt) i përgjithshëm, dhe se asambleistët potencialisht mund të kenë prona të tyre apo të personave të afërm të cilat janë pjesë e PZHK-së, për këtë shkak Agjencia fare nuk ka zhvilluar hetim administrativ në këtë drejtim. Por, konstatimi i konfliktit të interesit në këtë rast është për shkak se z. Fitim Gatica ka marrë pjesë në votim – vendimmarrje (madje ka qenë vota përcaktuese e kuorumit) për miratimin e PZHK-së, pjesë e të cilit plan ka qenë edhe kërkesa (individuale) e tij për lejimin e shndërrimit të pronave (parcelave) të tij në tokë ndërtimore, si dhe aprovimi i kërkesës së tij për shtatë (7) parcela.

Pra, kjo situatë ka rezultuar si konflikt i interesit për shkak të përfshirjes së kërkesës (individuale) të z. Fitim Gatica dhe aprovimit të saj në PZHK - interesi privat i zyrtarit dhe për shkak të pjesëmarrjes së tij në votim për miratimin e PZHK-së – vendimmarrja, në të cilin ai ka pasur interes privat. E jo për faktin se i njëjti ka qenë asambleist i cili ka pasur prona në Komunën e Kamenicës dhe PZHK-ja si akt i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës ka përfshirë edhe pronat e asambleistëve, në këtë rast edhe ato të z. Fitim Gatica.

Nga sa u tha më lartë, pjesëmarrja e z. Fitim Gagica në votimin e PZHK-së, paraqet situatë të konfliktit të interesit dhe si e tillë bie ndesh me nenin 6 dhe 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së.

II. Kërkesa e Agjencisë si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi është bazuar në nenin 22 paragrafi 13 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *"Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit"*, nenin 24 paragrafi 5 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *"Agjencia inicicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi"*, pastaj në nenin 22, paragrafi 11 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Organet kompetente njoftojnë Agjencinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e njoftimit për veprimet e ndërmarra prej tyre"*.

Për më tepër, me nenin 12 [Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ], paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.5 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, është përcaktuar se: *"1. Veprimet e Agjencisë në raport me epilogun e procedurës së zhvilluar të hetimit administrativ përfshijnë, por nuk kufizohen në: [...] 1.5. kërkesë për rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit nga organi që e ka nxjerrë atë."*

Kësisoj, me qëllim që të ndalen dhe evitohen pasojat juridike të Vendimit nr. 01-21270, i datës 06.08.2025 për miratimin e PZHK-së, Agjencia kërkon nga KK i Komunës së Kamenicës të revokoj ose shfuqizoj vendimin në fjalë, si akti i nxjerrë nën rrethana të konfliktit të interesit, ashtu që votimi i PZHK-së të (ri)kthehet në KK të Komunës së Kamenicës për votim nga një përbërje pa konflikt të interesit, dhe më pas të njoftohet Agjencia për masat e ndërmarra. Në këtë rast të merren në konsideratë edhe dispozitat përkatëse për anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

III. Lidhur me konstatimin për shkelje të dispozitës së nenit 17, paragrafi 1 të LPKI-së, si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, Agjencia konform nenit 23, paragrafi 3 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *"Për veprat kundërvajtëse, Agjencia dhe çdo institucion punëdhënës inicicion procedurën kundërvajtëse në pajtim me ligjin"*, do të inicioi procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente ndaj zyrtarit z. Fitim Gagica, për faktin se sipas nenit 23, paragrafi 1, të ligjit në fjalë *"Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj e që nuk përbënë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë si më poshtë [...]"*, në rastin konkret sipas nën-paragrafit 1.6 të këtij neni.

Për më tepër, me dispozitën e nenit 24 [Përgjegjësitë e tjera ligjore dhe pasojat mbi aktet], paragrafi 1 të LPKI-së, është përcaktuar se: *"Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësi eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji duhet ta njoftojnë Agjencinë për iniciimin dhe rezultatin e atyre procedurave."*

Gjithashtu, kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse bazohet edhe në dispozitën e nenit 17 [Fillimi i hetimeve administrative], paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me të cilën është përcaktuar se: *"Në rast se gjatë hetimit"*

administrativ dyshohet për kundërvajtje, Agjencia inicion dhe zhvillon vet procedurën kundërvajtëse ose e referon atë në gjykatën kompetente në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.”

IV. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.


Yll Buleshkaj
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit z. Fitim Gagica;
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës z. Kadri Rahimaj;
- Kryesuesit të KK i Komunës së Kamenicës;
- Drejtorit të DPKI-së;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).